



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARNIVIT-KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Musua Org. Org. Jeshv. Org. Unit	01	Nr. Prot. Et. Proa. Prot. No.	162
Nr. i fageve Broj stranica No. pages	03	Data Datum Date	01/10/2012
PRISHTINË/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. prot. 23/2012
Datë: 01.10.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. Të ndalohet përkohësisht vëzhgimi me kamerë në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të ndërtesës së N. Sh. Stacioni i Autobusëve - Prishtinë.
2. Vëzhgimi me kamerë në hapësirat sipas pikës 1. të këtij vendimi mund të fillojë vetëm pas zbatimit të dispozitave ligjore të parapara në nenet 61, 62, 64 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. N. Sh. Stacioni i Autobusëve - Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, nenit 47 dhe nenit 48 (paragrafi 1.1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 18.09.2012 Agjencia ka realizuar kontroll sipas detyrës zyrtare në N. SH. Stacioni i Autobusëve-Prishtinë dhe ka konstatuar se vendosja e sistemit të vëzhgimit me kamerë nuk përmbushë rregullativën ligjore.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.03/2012, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i N. SH. Stacioni i Autobusëve-Prishtinë dhe të njëjtit zyrtar i është dorëzuar një kopje.

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë - Kosovë

Në bazë të kontrollit të bërë në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

N. SH. Stacioni i Autobusëve - Prishtinë ka të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamerë por nuk ka vendim të shkruar për instalimin e sistemit të vëzhgimit. Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë. Një kamerë është e vendosur në hapësirën e brendshme të ndërtesës, ku ajo kamerë monitoron lëvizjet e të punësuarve dhe personave të tjerë që lëvizin në atë pjesë. Në nenin 62, paragrafin 4, thuhet që sistemet e vëzhgimit me kamerë mund të mbikëqyrin pjesën e jashtme dhe hyrjen e ndërtesës, por jo edhe hyrjen dhe brendinë e apartamenteve.

Nga vëzhgimi me kamerë perfshihet edhe nje hapësire jashte hapësires (prones) se N.SH.Stacioni i Autobusëve-Prishtinë.Ky vëzhgim nuk duhet te behet pasi qe i tajkalon qellimin per te cilin eshte vendosur sistemi i vëzhgimit. Ne nenin 3 (paragrafi 1 dhe 3) te LMDHP thuhet se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar më tutje.

Njoftimi për instalimin e sistemet të vëzhgimit me kamerë nuk është vendosur. Në nenin 61 (paragrafi 2) të LMDHP thuhet se personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'u mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur vëzhgimi me kamerë fillon.

N. SH. Stacioni i Autobusëve - Prishtinë, para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë nuk ka informuar me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Në nenin 64 (paragrafi 4) të LMDHP, thuhet se para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë, punëdhënësi duhet t'i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshtatshme.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ramadan Qehaja
Mbikëqyrës Shtetëror



Vendimi i dërgohet:

- N. Sh. Stacioni i Autobusëve - Prishtinë
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë